



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 33, datë 24.03.2020

**“PËR
AMENDIMIN E KONTRATËS TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT ME OPERATORIN
“FUSHA” SHPK PËR ZONËN TIRANA IV NË KUADËR TË MARRJEVE TË
MASAVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË
SHKAKTUAR NGA COVID-19”,**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5/1 të Aktit Normativ nr. 3, datë 16.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, të ndryshuar, Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e amendimit të kontratës nr. 21495/19 prot, datë 27.12.2017 të shërbimit të Pastrimit të Zonës Tirana IV të diktuar nga situata emergjente me operatorin “Fusha” shpk, në kuadër të marrjeve të masave gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Amendimi i kontratës të cituar në pikën 1 të këtij vendimi, ka të bëjë me shtimin e frekuencës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane dhe larja dhe dezinfektimi i kontenierëve në funksion të pastrimit të Zonës Tirana IV, si masë për parandalimin e përhapjes së infeksionit të COVID-19.
3. Shpenzimet mbulohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2020 të miratuar për këtë qëllim.
4. Amendimi i kontratës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga zëvendëskryetari i bashkisë

në cilësinë e autoritetit kontraktor të Bashkisë Tiranë.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI


TONI GOGU

